

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Rehabilitimi i kanalit ushqyes te ujembledhesit Llakaj dhe rehabilitimi i skemes ujtese”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44130000-0 - Kanalizime kryesore

VLERA E FONDIT LIMIT: 96,935,269.17 (Nentëdhjetë e gjashtë milion e nentëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nente pike shtatëmbëdhjetë) Leke pa TVSH. Konkretisht në vitin 2026 janë akorduar fondet në vlerë 24,000,000 (Njëzetë e katër milion) Leke me tvsh, në vitin 2027 janë akorduar fondet në vlerë 35,000,000 (Tridhjetë e pesë milion) Leke me tvsh dhe në vitin 2028 janë akorduar fondet në vlerë 57,322,323 (Pesëdhjetë e shtatë milion e treqind e njëzetë e dy mijë e treqind e njëzetë e tre) Lekë me tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Has** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk

është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 8.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Perzgjedhjes / Kualifikimit pika 1 e Shtojcës 7

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një

nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës objekt prokurimi.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht:

Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i cili përcakton” Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar pika 3.12 e tij, dhe kërkesave të **Ligjit Nr. 25** date **10.05.2018** “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 9 i tij ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministripërgjegjës për financat”.

Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” gjykojmë që të kërkojmë xhiron vjetore dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2022, 2023, 2024) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

*“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”*

2.2.3 Operatorët Ekonomike ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2025 dhe keestet e maturuara për vitin 2026.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Njësia e prokurimit kërkoi edhe pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (të ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatorët Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratat;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt Kolaudimi
5. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
6. Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e përhershme të marrjes në dorezim

-Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë sipermarrje;
2. Leje për kryerje punimesh
3. Situacionin përfundimtar;
4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore;
5. Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e përhershme të marrjes në dorezim;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim: Për punet e ngjashme të realizuara si BOE krahas dokumenteve të mesiperme duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku përcaktohet ndarja e zerave të punimeve ndërmjet paleve, ndërsa për punet e ngjashme të realizuara si nenkontraktor duhet të paraqitet edhe kontrata e nenkontraktimit ku përcaktohen zërat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë**

të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore **dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.**

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Njësia përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qënë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sipas këtij neni, Njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacioneve ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe kontratën e sipërmarrje, aktin e kolaudit, situacionin përfundimtar, certifikaten e marrjes në dorezim të përkohshëm/përfundimtar si dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike, për të patur mundësi të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kerkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Gjithashtu është kërkuar nga njësia e prokurimit në DST:

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe

Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

Me anë të këtij dokumentacioni autoriteti kontraktor ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala **“kërkon”** nënkupton se këto kritere janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

Njësia përcaktoj kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Referuar natyrës së kontratës për punë publike, njësia vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacionit ligjor të zbatimit të punimeve, bazuar në ligjin Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b të VKM-së, të paraqesin dhe kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, si dhe Faturat Tatimore sipas legjislacionit në fuqi, për të vërtetuar faktin, nëse operatori ekonomik pjesëmarrës zotëron eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1.

Duke qënë se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që A.K., të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

2.3.2 Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- | | |
|---|----------------------|
| • Kategoria NP- 1 Punime germimi në toke | Klasifikimi A |
| • Kategoria NP-7 Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje | Klasifikimi C |
| • Kategoria NP- 5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti | Klasifikimi A |

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- | | |
|---|----------------------|
| • Kategoria NS-9 Punime strukturorë speciale | Klasifikimi A |
| • Kategoria NS-18 Punime topogeoedezike | Klasifikimi A |

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike që ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar në të cilët përcaktohet:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... c) aftësinë teknike dhe profesionale;...

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 6 dhe 8** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. **285, datë 19.5.2021** “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës;

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Proçedurat e Dhënies së Liçencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(të ndryshuar), dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe proçedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në liçensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë propocionale me objektin e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	Sipas preventivit - Germim ekskavator kategoria IV per rrugen; Germim me ekskavator shkemb i bute per priten, per shpatullat etj.	A	0-20 milion

NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	<i>Sipas preventivit - Kalim tub çeliku; nenkalim tubo betony etj.</i>	A	0-20 milion
NP - 7	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje	<i>Sipas preventivit, Gabiona me rrjet teli te xinguar gur kave; Tombino betoni; tub çeliku etj.</i> Funksioni i kësaj licence lidhet me: 1. Ndërtimin dhe rehabilitimin e kanaleve vaditëse; 2. Sistemet e shpërndarjes së ujit; 3. Veprat e kullimit; 4. Tombinot; 5. Tubacionet e transmetimit; 6. Strukturat hidraulike ndihmëse.	C	51-100 milion
N.S- 9	Punime strukturorë speciale	<i>Sipas preventivit , F.V. Gabion me rrjetë tel xingato..., Struktura monolite betoni..., Puseta hyrje/ dalje..., F.V. hekur betoni..., etj.</i>	A	0-20 milion
N.S-18	Punime topogjeodezike	<i>Sipas preventivit</i> Kjo licensë është shumë e arsyeshme dhe e argumentueshme për këtë objekti, pasi kantieri përfshin: - Kanal vaditës me gjatësi të konsiderueshme; - Tubacione të shumta; - Tombino; - Gabione; - Struktura betoni; - Gjermime lineare. Realizimi i ketyre punimve te paraqitura dhe te preventivuara realisht dhe konkretisht ka nevojë për: 1. Piketim fillestar; 2. Kontroll aksesh; 3. Kontroll kuotash; 4. Kontroll pjerrësish; 5. Rilevime gjatë zbatimit; 6. Matje për situacionet mujore. Funksioni i kesaj licence është të garantojë dhe të sigurojë : a) Saktësinë planimetrike; b) Saktësinë altimetrike; c) Respektimin e projektit; ç) Dokumentimin gjeodezik të	A	0-20 milion

		punimeve.		
--	--	-----------	--	--

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një punësim mesatar të paktën **65 (Gjashtedhjetë e pese)** punonjes me kohe të plotë duke përfshirë dhe stafin teknik, për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mësipërme në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”*. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:
 - Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
 - Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* në të cilin parashikohet: *“I. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.**”* Në nenin 39 *“Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”* pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”* të ndryshuar, parashikohet: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe /ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë*

kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirjen e percaktuar (afatin e punimeve) **tregon besueshmëri për autoritetin.** Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe rregjistrimi i punonjësve në rregjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomike, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, gjithashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendorsja e kriterit për një punësim mesatarisht të paktën **65 persona** duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.

Gjithashtu, referuar projektit, preventivit, grafikut të punimeve, specifikimeve teknike, matjeve që ka bërë projektuesi, është vlerësuar ky numër i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomike që nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Nga llogaritja e oreve të punës për të gjithë zerat e punimeve të preventivit, sipas manualit të çmimeve për fuqinë punëtore konkludojmë si më poshtë:

Total ore pune = 143,000 ore (sipas zerave të preventivit)

Ore / 1 dite pune = 8 ore

Total dite pune puntori = 143,000 ore / 8 ore = 17,875 dite pune

Dite pune gjithsej = 275 dite (sipas grafikut të punimeve)

Numri i fuqisë punëtore = 17,875 dite / 275 dite = 65 punëtor

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore). Në mënyrë të përmblodhur numri i fuqisë punëtore që kërkohet për realizimin e punimeve është min 65 punonjës.

Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** të cilet të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

- | | |
|--|---------|
| ➤ Inxhinier Ndërtimi | 2 (dy) |
| ➤ Inxhinier Hidroteknike | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Mjedisi | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Gjeolog | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Mekanik | 1 (një) |

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë (Drejtuesit teknik të jenë të siguar sipas legjislacionit në fuqi).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. **Drejtuesi teknik është përgjegjës** për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe **vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën**, njësia e prokurimit referuar zërave të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, **vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara**. Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik), ku më hollësisht parashtrijmë:

Është kërkuar **Inxhinier Ndërtimi**, pasi projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi dhe tipologji të madhe të punimeve të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e gërmimit, punimet e shtresave, etj. Punimet e ndërtimit duhet të përmbushin kushtet teknike të zbatimit. Respektimi i kërkesave për qëndrueshmëri strukturore, plotësimi i kërkesave për mbrojtjen nga zjarri, përdorimi i materialeve që nuk janë të dëmshëm për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve dhe saktësia në realizimin e të gjithë elementëve konstruktivë sjellin domosdoshmërinë që çdo element dhe hallkë e zbatimit të këtyre punimeve të ndiqet dhe udhëhiqet nga ekspertët të licensuar të fushës.

Kërkesa për 2 (dy) Inxhinierë Ndërtimi është plotësisht e justifikuar nga natyra dhe volumi i punimeve të objektit. Kërkesa për keta inxhinier ndërtimi, pra 2 (dy) është e domosdoshme për shkak të natyrës së punimeve që përfshin rehabilitimin ose ndërtimin. Përveç funksionit hidraulik, objekti përmban një numër të konsiderueshëm punimesh civile dhe strukturore, të cilat kërkojnë drejtim Teknik dhe kontroll të vazhdueshëm nga specialist dhe profesioniste të kësaj fushe. Në preventiv janë parashikuar për zbatimin e punimeve: beton për ankerë / puseta etj; konstruksione dhe tubacione çeliku; armaturë hekuri; tombino betoni Ø600 / 800; gabione mbrojtëse; riparime strukturash ekzistuese; shtresa të ndryshme mbushjeje. Inxhinieri i Ndërtimit është figura kryesore përgjegjëse për organizimin teknik të kantierit dhe kontrollin e zbatimit të punimeve civile dhe strukturore. Detyrat kryesore që do të kenë 2 (dy) inxhinierët e ndërtimit për zbatimin e kësaj veprë, që për nga rëndësia konsiderohet e madhe, përfshijnë: a) Organizimin dhe drejtimin teknik të punimeve; b) Kontrollin e zbatimit sipas projektit; c) Kontrollin e cilësisë së betonit dhe armaturës; ç) Verifikimin e dimensioneve gjeometrike të strukturave; d) Kontrollin e proceseve të betonimit; dh) Mbikëqyrjen e montimit të tubacioneve dhe elementeve metalike; e) Koordinimin e makinerive dhe forcës punëtore; ë) Hartimin dhe kontrollin e dokumentacionit teknik të zbatimit. Numri prej 2 (dy) inxhinierësh justifikohet nga shtrirja lineare e objektit dhe nga nevoja për ndjekje të njëkohshme të disa fronteve pune, ku njëri mund të mbulojë punimet e gërmimit dhe strukturat civile, ndërsa tjetri veprat hidraulike, tubacionet dhe strukturat e betonit.

Është kërkuar **Inxhinier Hidroteknik** pasi objekti është një vepër tipike hidroteknike dhe vaditëse, prandaj kërkesa për inxhinier hidroteknik në zbatimin e një veprë hidraulike, është plotësisht e justifikuar dhe argumentuar për shkak të natyrës specifike të punimeve dhe funksionit që do të kryejë vepra. Zbatimi i tij kërkon drejtimin dhe mbikëqyrjen e specialisteve/profesionistëve me formim hidroteknik, të cilët garantojnë funksionimin e sigurt dhe efikas të sistemit të ujitjes dhe vaditjes. Vetë qëllimi i investimit është rehabilitimi dhe funksionalizimi i sistemit të transportit dhe shpërndarjes së ujit për vaditje. Në preventivin e këtij rehabilitimi me përmbajtje hidroteknike vaditje, të cilat do të zbatohen në kantier, janë përfshirë: Kanali vaditës; Tombino Ø800 / 600; Tubacione çeliku, Struktura hidraulike prej betoni; Gabione mbrojtëse; Hidroizolime dhe rehabilitime kanalesh. Inxhinieri Hidroteknik është specialisti kryesor për kontrollin e funksionimit hidraulik të veprës. Prania e inxhinierit hidroteknike është thelbësore, pasi edhe devijime të vogla në pjerresë, kuota ose seksionin e kanalit mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në kapacitetin e rrjedhës, shpërndarjen e ujit, humbjet hidraulike dhe funksionimin e të gjithë sistemit të vaditjes. Detyrat kryesore që do të kenë inxhinier hidroteknik në zbatimin e kësaj veprë, përfshijnë: kontrollin e kuotave hidraulike; verifikimin e pjerrësive të kanalit; kontrollin e seksioneve hidraulike; verifikimin e kapacitetit përcjellës të ujit; kontrollin e vendosjes së tubacioneve; kontrollin e tombinove dhe veprave të kalimit; analizimin e ndikimit të rrjedhjeve; kontrollin e disipimit të energjisë së ujit; monitorimin e masave kundër erozionit; bashkërendimin e punimeve me disiplinat e tjera inxhinierike, për të garantuar integritetin korrekt të veprave civile me funksionin hidraulik të objektit; verifikimin e kapacitetit hidraulik të kanalit gjatë zbatimit, duke garantuar që seksioni i realizuar përmbush prurjen e projektuar; kontrollin e zbatimit të masave për mbrojtjen nga erozioni, gërryerja dhe sedimentimi, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në jetegjatesinë dhe funksionin hidraulik të objektit; verifikimin e cilësisë së materialeve dhe të punimeve që ndikojnë në performancën hidraulike të veprës; kontrollin e funksionimit të sistemit pas rehabilitimit / ndërtimit. Për shkak të gjatësisë së kanalit, numrit të konsiderueshëm të veprave hidraulike dhe rëndësisë së funksionimit korrekt të sistemit të vaditjes, kërkesa për Inxhinierë Hidroteknikë është plotësisht e justifikuar, me argumentimin e shtuar ku do të ndjekë punimet lineare (profili, pjerresit, seksioni dhe veshja), dhe do të mbikëqyrë rehabilitimin/ndërtimin dhe funksionimin e veprave hidraulike (porta, tombino, shkarkues, ndaresë

etj....), duke garantuar kontroll teknik te vazhdueshem dhe realizimin e vepres ne perputhje me projektin dhe specifikimet teknike.

Është kërkuar **Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder** pasi objekti përfshin punime lineare me kërkesa të larta për saktësi planimetricke dhe altimetrike. Kërkesa për 1 (nje) inxhinier gjeodet ne zbatimin e nje vepre hidraulike, eshte plotesisht e justifikuar dhe argumentuar, pasi saktësia gjeometrike dhe altimetrike e kanalit eshte nje nga faktoret kryesore qe garanton funksionimin korrekt te tij. Duke qene se rrjedhja e ujit ne kanalet/tubat vaditese te ketij objekti realizohet kryesisht me gravitet, cdo devijim ne kuota, pjerresi ose pozicionim mund te ndikojte drejtperdrejt na kapacitetin hidraulik dhe ne funksionalitetin e vepres. Punimet qe do te ndjekin ne zbatim inxhinieri gjeodet, te cilat jane edhe te pasqyruara ne preventive, përfshijnë: Gërmime lineare; Tubacione me gjatësi të konsiderueshme; Tombino; Struktura betoni; Gabione; Sistem vaditës që funksionon mbi bazën e pjerrësive të projektuara. Gabimet minimale në kuota ose aks mund të sjellin mosfunksionim të sistemit hidraulik, prandaj prania e 1 (nje) inxhinieri gjeodet ne kete objekt apo kantier eshte mese i domosdoshem dhe i argumentuar. Detyrat qe do te kete Inxhinierii Gjeodet gjate zbatimit te kesaj vepre, por jo vetem , përfshijnë: pike timin e aksit të kanalit; pike timin e veprave të artit; kontrollin e kuotave të projektit; rilevimet topografike gjatë zbatimit; matjen e volumeve të gërmimeve; kontrollin e pozicionimit të tubacioneve; përgatitjen e dokumentacionit gjeodezik; kryerjen e matjeve perfundimtare (as-build), duke verifikuar qe objekti eshte realizuar sipas projektit dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik per marjen ne dorezim. Per kete arsye, prania e **1 (nje)** inxhinieri gjeodet gjate fazes se zbatimit eshte e domosdoshme per te garantuar saktesine e punimeve, cilesine e realizimit dhe funksionimin afatgjate te vepres hidraulike.

Është kërkuar **Inxhinier Mjedis** duke u mbështetur tek zerat e preventivit, kërkesa për 1 (nje) inxhinier mjedisi eshte e domosdoshme dhe e nevojshme, sepse objekti përfshin volume te konsiderueshme germimesh, transporti dhe sistemimi terreni, te cilat krijojne ndikime te drejtperdrejta ne mjedis. Kjo kërkesa për 1 (nje) inxhinier mjedisi ne kantier eshte e nevojshme dhe ne perpjestim me natyren dhe kompleksitetin e objektit, pasi përfshijne volume te konsiderueshme germimesh, transporti materialesh, mbushjesh dhe sistemime terreni, te cilat krijojne ndikime te drejtperdrejta ne mjedis dhe kerkojne monitorim te vazhdueshem gjate gjithë fazes se ndertimit. Punimet qe do te monotorojte dhe zbatoje inxhinieri i mjedisit te preventivuara ne raport me projektin, përfshijne : transport materialesh; gërmime në tokë dhe shkëmb mesatar, Germim per themele dhe plinta, Depozitimin, mbushjen dhe ngjeshjen e materialeve të germuar, Rehabilitim të një infrastrukture ekzistuese; Ndërrhyrje në mjedis natyror, etj. Keto punime shoqerohen me perdorimin intensiv te makinerive te ndertimi, levizje te vazhdueshme te mjeteve te transportit, depozitimin e perkohshem te materialeve te germuara dhe nderhyrje te drejtperdrejta ne terren te cila, nese nuk monitoren sipas kërkesave teknike dhe mjedisore, mund te shkaktojne ndotje te tokes dhe ujrave, pluhur, zhurme, erosion te terrenit, si dhe depozitime te pakontrolluara te materialeve. Si rezultat i ketyre ndikimeve ne mjedis dhe ne natyre ne kete kantier eshte i nevojshem 1 (nje) Inxhinierii Mjedis. Detyrat qe duhet te ndjekin inxhinieri i mjedisit ne kete kantier, përfshijnë: **a)** Monitorimin e ndikimit mjedisor; **b)** Kontrollin e pluhurave dhe ndotjes; **c)** Menaxhimin e mbetjeve inerte; **ç)** Kontrollin e zonave të depozitimit dhe marjen e masave per mbrojtjen e tokave bujqesore dhe te siperfaqeve perreth kanalit gjte zhvillimit te punimeve; **d)** Monitorimin e ndikimit në tokat bujqësore; **dh)** Monitorimin e ndikimit në ujërat sipërfaqësore; **e)** Hartimin e masave korrigjuese mjedisore; **ë)** Kontrollin e rehabilitimit të zonave të prekura; **f)** dokumentimin dhe raportimin e respektimin te kushteve mjedisore te parashikuara ne projekt dhe ne legjislacionin ne fuqi. Për shkak të karakterit mjedisor të veprës dhe ndërhyrjeve të konsiderueshme në terren, kërkesa për 1 (nje) inxhinier mjedisi konsiderohet propocional i arsyeshem dhe teknikisht i domosdoshem per garantimin e zbatimit

te masave per mbrojtjen e mjedisit, respektimin e legjislacionit ne fuqi dhe realizimin e punimeve sipas standarteve teknike.

Është kërkuar **Inxhinier Gjeolog**, pasi argumentimi lidhet ngushte me praninë e germimeve ne shkemb dhe me verifikimin e kushteve gjeologjike te terrenit. Kjo kerkese per kete inxhinier eshte e domosdoshme dhe ne perpjestim me natyren e punimeve, pasi objekti perfshin germime te konsiderueshme ne terrene me karakteristike te ndryshme gjeologjike, duke perfshire germime ne dhe, germime per themele, germime ne shkemb mesatar dhe ne shkemb te forte, ta cilate kerkojne vleresim dhe monitorim te vazhdueshem te kushteve gjeologjike gjate zbatimit. Prania e sasive të konsiderueshme të gërmimeve në shkëmb, se bashku me gërmimet per themele dhe punime lineare pergjate kanalit, tregon qartë se objekti zhvillohet në kushte të ndryshme gjeologjike, ku si rrjedhoje kerkon monitorim te vazhdueshem te perberjes se terrenit, ta stabilitetit te formacioneve gjeologjike dhe te perputhshmerise se kushteve reale me ato te parashikuara ne projekt. Inxhinieri Gjeolog ne keto kushte ne kete kanier ndertimi per realizimin e vepres do te jete përgjegjës për: **1)** Identifikimin e shtresave gjeologjike; **2)** Klasifikimin e materialeve të gërmimit; **3)** Kontrollin e stabilitetit të skarpave; **4)** Evidentimin e zonave me rrezik rrëshqitjeje; **5)** Kontrollin e kushteve gjeologjike gjatë hapjes së kanalit; **6)** Verifikimin e përputhjes së kushteve reale me projektin; **7)** Bashkepunimin me inxhinierin e ndertimit, hidroteknikun dhe gjeodetin per pershatatjen e zgjidhjeve teknike ne rast ndryshimesh te kushteve te terrenit; **8)** Dokumentimin teknik te problematikave gjeologjike te konstatuara gjate zbatimit dhe raportimin e tyre te drejtuesi teknik dhe investitori. Ne nje veper lineare mund te ndryshojne pergjate gjurmes se objektit. Ndryshimet ne perberjen e terrenit, prania e formacioneve shekembore, zonave te paqendrueshme ose materialeve me karakteristika te ndryshme mekanike ndikojne drejtperdrejte ne menyren e realizimit te germimeve, stabilitetin e kanalit dhe sigurise gjate punimeve. Per kete arsye, angazhimi i 1 (nje) inxhinieri gjeolog konsiderohet propocional dhe teknikisht i argumentuar per monitorimin e kushteve gjeologjike te terrenit, ku do te rehabilitohet ky kanal vadites.

Është kërkuar **Inxhinier Mekanik**, ne raport me zerat ndertimore dhe punimet te paraqitur ne preventiv dhe ne projekt. Fokusi apo puna e tij do te drejtohet tek sjellja mekanike e terrenit dhe ndikim i saj ne sigurine dhe qendrueshmerine e vepres. Kerkesa per 1 (nje) inxhinier mekanik eshte e domosdoshme dhe ne raport me natyren e punimeve, kompleksitetin dhe volume e tyre, pasi realizimi i rehabilitimit te kanalit vadites perfshin germime te konsiderueshme ne terrene me karakteristika te ndryshme mekanike, punime per themele, mbushje dhe ngjeshje materialesh, si dhe ndertimin e veprave hidraulike qe mbeshteten drejtperdrejt mbi terrenin natyror. Sipas preventivit qe shoqeron projektin, objekti perfshin gërmime të thella, mbushje dhe ngjeshje, gabione mbrojtëse, struktura betonarmeje, tubacione të vendosura në terren natyror, stabilizim të seksioneve të kanalit etj. Inxhinieri Mekanik është specialisti që garanton sjelljen mekanike të terrenit dhe sigurinë e veprës. Keto punime kerkojne kontroll te vazhdueshem te karakteristikave gjeoteknike te terrenit, me qellim garantimin e stabilitetit te kanalit, te vaprave hidraulike dhe te strukturave ndihmese gjate ndertimit dhe gjate gjithë jetes se sherbimit te objektit/vepres. Detyrat kryesore jane: kontrollin e kapacitetit mbajtës të terrenit, kontrollin e ngjeshjes së mbushjeve, analizën e stabilitetit të skarpave, kontrollin e bazamenteve të strukturave, vlerësimin e deformimeve të mundshme, kontrollin e kushteve të themelimit të gabioneve, monitorimin e sjelljes së terrenit gjatë zbatimit. Për shkak të volumeve të mëdha të gërmimeve, mbushjeve dhe pranisë së strukturave mbajtëse, konsiderohet e nevojshme dhe teknikisht e argumentuar.

- c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të përcaktojë me anë të një **deklaratë** (nga Administratori i Shoqërisë) **Drejtuesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperience) në objekt, i cili duhet të jetë i

përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Gjithashtu, me qëllim ndërtimin e objektit të vepres sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qënë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 milion në zbatim të Udhëzimit Nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, të përfshirë në licencimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Drejtuesi teknik duhet të disponojë kualifikimet e kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

e) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar 16 (Gjashtembëdhjete) punonjes të kualifikuar për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, Certificate trajnimiti (të vlefshme), ose Deshmi Profesionale lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë, si më poshtë:

Teknik Ndërtimi	1 (nje)
Teknik Topograf	1 (nje)
Teknik Hidroteknik	1 (nje)
Teknik Mekanik	1 (nje)
Karpiertier	5 (pese)
Hekurkthyes	3 (tre)
Betonues	4 (kater)

Saldator	3 (tre)
Hidraulik	3 (tre)
Murator	3 (tre)
Shofer	5 (pese)

Shoferet për drejtim mjetesh duhet të jenë të pajisur me leje drejtimi me kategorine "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE" leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Shënim: Për shoferët, Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t'i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojë tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Nr kontrates Profesionit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar natyrës, dhe përmasave/ volumit të punimeve që përmban objekti i prokurimit, **me qëllim vërtetimin e aftësisë zbatuese të kontratës**, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomik duhet të disponojnë stafin mbështetës të kualifikuar për kryerjen e të gjitha punimeve objekt prokurimi, pasi pa këto punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi.

Jane kërkuar punonjes të specializuar dhe të certifikuar me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe **vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.**

Teknik i mesëm Ndërtimi, referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit;

Teknik mesëm Topograf/ Gjeometër, referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit dhe matjeve duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit;

Teknik i mesëm Hidroteknik, referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve hidroteknike si: vendosjen e tubave, saraçineskave, pusetave etj., duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit;

Teknike mekanik, referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve në lidhje me vendosjen e tubave me peshëmbajtje të kosiderueshme, ku gjithashtu referuar tonazhit dhe llojeve të automjeteve/ makinerive që do të angazhohen për kryerjen e punimeve objekt kontrate, ka nevojë që dislokimi dhe drejtimi i tyre të mbikqyret nga ana e tij, duke qenë se terreni ku do të kryhen punimet është i papërshtatshëm dhe me lartësi të konsiderueshme;

Specialist karpentier - bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve të vendosjes së armaturës për punimet e betonit dhe pusetave;

Hekurkthyes - referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve të hekurit;

Betonues - referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve të hapjes së betonit dhe procesit të betonimit. Kërkesa për numrin lidhet referuar sasisë dhe grafikut të punimeve dhe faktit që punimet do kryhen në segmente të njëjta për të arritur eficiencën dhe kohën;

Saldator - bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve saldimit të tubave dhe konstruksioneve metalike,

Hidraulik - bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve hidraulike të tubacioneve, pusetave hyrje dalje, vendosjen e saraçineskave etj.

Muratore - është e nevojshme pasi ato do të merren me punime ndërtimore jo-strukture të betonit. Në një objekt hidroteknik, muratoret janë të nevojshme për realizimin e mureve mbajtës, strukturave mbështetëse, veprave të vogla të artit, pusetave, kanaleve ndihmëse, riparimeve etj.

Janë kërkuar **shofer**, të cilët janë të nevojshëm, pasi objekti përfshin një volum të konsiderueshëm transporti materialesh dhe përdorimin e një numri të madh mjeteve transporti gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve. Në preventivin e objektit janë parashikuar **transport materialesh**, që përfshijnë transportin e dheut dhe shkëmbit të gërmuar, transportin e çakëllit, zhavorrit dhe agregateve të tjera, furnizimin me beton, hekur betoni, tuba çeliku, gabionë, materiale hidroizoluese dhe materiale të tjera ndërtimi të nevojshme për realizimin e veprës. Gjithashtu, në listën e makinerive dhe pajisjeve janë parashikuar **rreth 8 kamionë, kamioncina dhe kamionë me vinç**, të cilët kërkojnë drejtues të pajisur me lejet përkatëse dhe me përvojë në operimin e mjeteve të transportit në kantieri ndërtimi. Shoferët janë përgjegjës për drejtimin e mjeteve të transportit, ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve në bashkëpunim me operatorët e makinerive, transportin e materialeve nga furnitorët në kantier dhe brenda vetë kantierit,

furnizimin e vazhdueshëm të fronteve të punës, si dhe transportin e makinerive, pajisjeve dhe elementëve prefabrikatë ose metalikë sipas nevojave të zbatimit. Ata janë gjithashtu përgjegjës për përdorimin e sigurt të mjeteve, respektimin e rregullave të qarkullimit dhe të sigurisë në punë, si dhe kontrollin e gjendjes teknike të automjeteve që drejtojnë.

f) Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të pakten:

- 3 (tre) Punonjes Eskavatorist
- 3 (tre) Punonjes Automakinist
- 2 (dy) Punonjes Buldozerist

të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontrate pune / shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës. Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontrate pune / shërbimi të vlefshme; Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontrate pune / shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontrate pune / shërbimi të vlefshme; Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Gjithashtu, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet që të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar për disponimin në stafin e tyre, të cilët duhet të disponojnë dëshmitë e nevojshme për drejtimin e mjeteve të rënda të kërkuara, me qëllim kryerjen e punimeve të gjurmimeve objekt kontrate, pasi pa këto mjete nuk mund të kryhen punimet objekt kontrate. Në përcaktimin e numrit të punonjësve manovratorë, njësia e prokurimit ka patur parasysh volumin e punimeve që do të kryhen, si dhe sasinë dhe llojin e mjeteve që nevojiten për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Kërkesa për **3 punonjës eskavatoristë** është plotësisht e justifikuar, pasi objekti përfshin një volum të konsiderueshëm punimesh gjurmimi dhe përgatitjeje të terrenit, të cilat mund të realizohen vetëm me makineri të rënda të operuara nga personel i kualifikuar. Eskavatoristët janë përgjegjës për operimin dhe manovrimin e eskavatorëve gjatë gjurmimeve të dheut dhe shkëmbit, realizimin e gjurmimeve në përputhje me kuotat dhe dimensionet e projektit, formimin e seksioneve të kanalit, hapjen e themeleve, ngarkimin e

materialeve të gërmuara, sistemimin e terrenit, si dhe përdorimin e çekiçit hidraulik për thyerjen e shkëmbit. Ata sigurojnë që punimet të kryhen me saktësi, duke respektuar parametrat teknikë të projektit, kushtet e sigurisë në punë dhe kërkesat për mbrojtjen e elementëve ekzistues të infrastrukturës. Për shkak të volumit të madh të gërmimeve, natyrës së ndryshme të materialit që do të gërmohet (dhe, shkëmb mesatar dhe shkëmb i fortë), si dhe nevojës për zhvillimin paralel të punimeve në disa fronte pune, angazhimi i **3 eskavatoristëve** është i domosdoshëm për operimin e njëkohshëm të makinerive të ndryshme, duke garantuar ritmin e zbatimit, shfrytëzimin efikas të makinerive dhe respektimin e grafikut të punimeve. Prania e eskavatoristëve të kualifikuar garanton realizimin e gërmimeve me cilësi, saktësi dhe siguri, duke shmangur devijimet nga projekti, dëmtimin e strukturave përreth dhe vonesat në zbatimin e punimeve. Për rrjedhojë, kërkesa për **3 punonjës eskavatoristë** është e argumentuar në përpjesëtim të drejtë me natyrën, kompleksitetin dhe volumin e punimeve të parashikuara në këtë vepër hidroteknike.

Kërkesa për **3 (tre) automakinistë** është plotësisht e justifikuar, pasi objekti përfshin një sërë punimesh që kërkojnë përdorimin e makinerive të ndryshme të ndërtimit për transportin, përhapjen, nivelimin, ngjeshjen dhe sistemimin e materialeve. Automakinistët janë përgjegjës për drejtimin dhe operimin e makinerive të ndërtimit, si autobetonierat, kamionët, autobotët, rulat, grejderët, ngarkuesit, fadromat ose makineri të tjera të nevojshme për transportin dhe përpunimin e materialeve në kantier. Ata kryejnë transportin e agregateve dhe betonit, përhapjen e shtresave, nivelimin, ngjeshjen mekanike, sistemimin e mbushjeve, si dhe mbështesin proceset e betonimit dhe punimet e tjera ndërtimore, duke garantuar zbatimin e tyre sipas parametrave teknikë të projektit. Për shkak të volumit të konsiderueshëm të shtresave të çakëllit dhe zhavorrit, sipërfaqes së madhe të pllakave të betonit, mbushjeve me materiale dhe nevojës për transport e sistemim të vazhdueshëm të materialeve në kantier, angazhimi i **3 automakinistëve** është i domosdoshëm për drejtimin paralel të makinerive, koordinimin e proceseve të punës dhe shmangien e vonesave gjatë zbatimit të objektit. Prania e automakinistëve garanton përdorimin e sigurt dhe efikas të makinerive, realizimin e punimeve me cilësi sipas specifikimeve teknike, respektimin e parametrave të projektit dhe përfundimin e objektit brenda afateve (grafikut të punimeve). Për rrjedhojë, kërkesa për **3 automakinistë** është në përputhje të plotë me natyrën, kompleksitetin dhe volumin e punimeve të kësaj vepre hidroteknike.

Kërkesa për **2 (dy) buldozeristë** është plotësisht e justifikuar, pasi objekti përfshin një volum shumë të konsiderueshëm punimesh gërmimi, mbushjeje, sistemimi dhe modelimi të terrenit, të cilat kërkojnë përdorimin e buldozerëve të operuar nga personel i kualifikuar. Në preventivin e objektit janë parashikuar **punime gërmimi dhe mbushjeje**, përfshirë gërmime në dhe, gërmime për themele dhe plinta, gërmime në shkëmb me çekiç hidraulik, mbushje me material të gërmuar, mbushje me çakëll, si dhe punime të shumta për përgatitjen dhe sistemimin e shtresave të infrastrukturës së kanalit. Buldozeristët janë përgjegjës për drejtimin dhe operimin e buldozerëve gjatë pastrimit të terrenit, shtyrjes dhe shpërndarjes së materialeve të gërmuara, formimit të platformave të punës, nivelimit paraprak të sipërfaqeve, sistemimit të mbushjeve, krijimit të rampave të aksesit për makineritë dhe modelimit të terrenit sipas kuotave dhe profileve të projektit. Ata bashkëpunojnë ngushtë me eskavatorët, automjetet e transportit dhe makineritë e ngjeshjes, duke siguruar një organizim efikas të proceseve të punës në kantier. Në një vepër hidroteknike të kësaj natyre, ku realizohen gërmime të thella, mbushje të konsiderueshme dhe punime lineare përgjatë gjurmës së kanalit, përdorimi i buldozerëve është thelbësor për lëvizjen e materialeve brenda kantierit, sistemimin e tyre, krijimin e kushteve të përshtatshme për vazhdimin e punimeve dhe ruajtjen e ritmit të zbatimit. Gjithashtu, buldozerët përdoren për mirëmbajtjen e rrugëve të përkohshme të kantierit dhe krijimin e fronteve të reja të punës. Për shkak të volumit të madh të punimeve, gjatësisë së objektit dhe nevojës për zhvillimin paralel të proceseve të gërmimit, mbushjes dhe

sistemimit të terrenit, angazhimi i **2 buldozeristëve** është i domosdoshëm për operimin e njëkohshëm të buldozerëve, rritjen e produktivitetit dhe respektimin e afateve kontraktuale. Prania e buldozeristëve të kualifikuar garanton përdorimin e sigurt dhe efikas të makinerive, realizimin e saktë të profileve të projektuara, cilësinë e mbushjeve dhe sistemeve, si dhe përfundimin e punimeve në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe standardet në fuqi.

g) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (në rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) “Person të ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit.
- 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) inxhinier që përmbush kriteret për të qenë “Përgjegjës për Sigurinë dhe Kontrollin e Cilësisë së materialeve”.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Kërkesa për “Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, është e lidhur me natyrën e kontratës dhe specifikat e saj, të cilat kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. **Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit.** Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Në lidhje me kërkesën për disponimin si pjesë të stafit të punësuar 1 (një) punonjes që disponon certifikatë/dëshmi si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, njësia e prokurimit

vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi ky inxhinier i certifikuar **nevojitet për përshtatjen e kantierit sipas fazave të punimeve, mbajtjen e kantierit në kushte të rregullta, kontrollin e materialeve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë dhe/ ose shëndetin e punëmarrësve, si dhe verifikimin e zbatimit të planit të sigurisë dhe koordinimit gjatë zbatimit të punimeve** kërkesa kjo në zbatim të nenit 9 dhe 10 të ligjit të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe nenit 2, 5 dhe 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”. Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) "Specialist per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune”.

Në lidhje me kërkesën për disponimin e **1 (një) inxhinier** që përmbush kriteret për të qenë “*Përgjegjës për Sigurinë dhe Kontrollin e Cilësisë së materialeve*”, vlerësohet si kërkesë e nevojshme, pasi duhet që një inxhinier të jetë i profilin për kontrollin e cilësisë në lidhje me punimet që do të kryhen dhe mallrat/materialet që do të furnizohen dhe vendosen në objektin e prokurimit, ku, referuar rëndësisë së veçantë që ka investimi objekt prokurimi (kanal vaditës), *vlerësohet me rëndësi fakti që të disponohet një inxhinier me këto njohuri të posaçme mbi kontrollin e cilësisë, pasi duke qënë prezent gjatë gjithë periudhës së punimeve ai vlerëson dhe kontrollon cilësinë e çdo punimi dhe materiali që kryhet dhe vendoset në objekt*, kërkesë kjo e cila i shërben A.K. për vërtetimin se operatori ekonomik jep garanci se punimet objekt prokurimi do të jenë brenda standarteve të kërkuara.

h) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërise ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes se bashkëpunimit.

Në lidhje me marrjen e masave për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, në zbatim të nenit 23 të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” në të cilin përcaktohet se, citojmë: “1. Çdo punëdhënës i një subjekti publik apo privat, vendas apo i huaj, është i detyruar të mbulojë me shërbim mjekësor, nëpërmjet mjekut të punës, të përshtatshëm për rreziqet që paraqet vendi i punës.”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar me VKM-në nr.632, datë 15.07.2015), në të cilin ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “7.Personi përgjegjës, i ngarkuar nga shërbimi i specializuar jashtë ndërmarrjes për menaxhimin e riskut, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:... b) në lidhje me shëndetin në punë të ketë formim profesional në fushën e mjekësisë së përgjithshme dhe i cili: b.1 të jetë kualifikuar si mjek i sëmundjeve profesionale/mjek pune; b.2 të jetë i licencuar nga Urdhri i Mjekut për ushtrimin e profesionit;...” duke qënë se është detyrim ligjor mbulimi me shërbim mjekësor të ndërmarrjes nga ana e punëdhënësit, dhe mbulimi i këtij shërbimi në aspektin shëndetësor duhet të kryhet nga mjeku i punës i licencuar, njësia e prokurimit vlerëson se, kërkesa për disponimin e mjekut të ndërmarrjes ose të kontraktuar është një detyrim ligjor për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar në përputhje me ligjin, duhet vërtetojnë disponimin e tij, i cili duhet të jetë i punësuar për periudhën e kërkuar, në përputhje me periudhën që është kërkuar punësimi i fuqisë punëtore kërkuar më lart.

2.3.4 Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik pjesëmarres duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat **duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera**, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 Ton	copë	3	Në pronësi ose me qera
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 15-20 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
3	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 5-10 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
4	Autovinç/ Kamion me Vinç	copë	2	Në pronësi ose me qera
5	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
6	Eskavator me krahe te gjate	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	copë	2	Në pronësi ose me qera
8	Eskavator me zinxhire	copë	2	Në pronësi ose me qera
9	Fadrome me goma	copë	2	Në pronësi ose me qera
10	Minieskavator/minifadrome	copë	2	Në pronësi ose me qera
11	Autobetoniere	copë	2	Në pronësi ose me qera
12	Autopompe betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Dumper	copë	2	Në pronësi ose me qera
15	Rrul vibrues gome cilinder mbi 18 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Rul cilinder - cilinder	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Motogjenerator / Gjenerator	copë	2	Në pronësi ose me qera
18	Çekic pneumatik	copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Kontenier Stacioner	copë	2	Në pronësi ose me qera
20	Rimorkiator mjetesh	copë	1	Në pronësi ose me qera
21	Tokmak Elektrik për ngjeshje dheu	copë	2	Në pronësi ose me qera

22	Vibrator betoni	copë	2	Në pronësi ose me qera
23	Saldatrice	copë	2	Në pronësi ose me qera
24	Matrapik	copë	2	Në pronësi ose me qera
25	Aparat për kthim dhe prerje hekuri (Tranxhë hekuri)	copë	1	Në pronësi ose me qera
26	Instrument për punime gjeodezike	copë	1	Në pronësi ose me qera
27	Total Station	copë	1	Në pronësi ose me qera
28	Betoforma	m2	200	Në pronësi ose me qera
29	Motosharrë për prerje bimësie	copë	1	Në pronësi ose me qera
30	Greider	copë	1	Në pronësi ose me qera

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e Rregullores për Sigurine në Kantier", si më poshtë vijon:

- Kokore + jelek fosforeshent minimumi 65 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronesinë e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata perkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë objekt i këtij prokurimi, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor sidhe të dekalroj dhe vendndodhjen e mjeteve në pronesi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti

Kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar në këtë procedurë prokurimi nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.** 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 6/d** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “**6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:... d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**”

1. Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kriteret detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme, njësia e prokurimit vlerëson se **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë automjetet, mjetet dhe pajisjet e kërkuara me anë të cilave do të kryhen punimet dhe transporti i materialeve sipas zërave të punimeve të përcaktuara në preventivin e specifikimit teknike objekt kontrate**, ku më hollësisht:

- Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min. 20 ton - u referohet analizave 3.331; 3.158/3a; 3.95/a etj.
- Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 15-20 ton - u referohet analizave 3.47/1b 3.331; 3.158/3a; 3.95/a etj.
- Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton - u referohet analizave 3.47/1b etj.;
- Autovinç/ Kamion me Vinç - u referohet analizave në lidhje me ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve nga kamionat e rënda në kamionat më të lehtë dhe kamionçina, si dhe shkarkimin e materialeve pranë vendndodhjes së punimeve përgjatë kanalit.

- Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton - kapaciteti i kërkuar i këtyre kamionçinave referohet rrugicave në të cilat do hasen vështirësi nga hyrja e mjeteve të rënda referuar relievit kodrinor ku shtrihen punimet e kanalit dhe mungesës së infrastrukturës rrugore.
- Eskavator me krahë të gjatë - u referohet analizave në lidhje me gërmimet e dheut të kanalit në vëndet ku për shkak të relievit kodrinor nuk mund të kryhen gërmimet e me eskavator me krah të shkurtër;
- Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma) - u referohet në lidhje me gërmimet e dherave të trasesë së kanalit;
- Eskavator me zinxhir - u referohet analizave në lidhje me gërmimet e dherave të trasesë së kanalit në vendndodhjet e kanalit ku mungon infrastruktura rrugore, dhe për shkak të relievit të thyer nuk mund të aksesohet nga eskavatorët me goma.
- Rimorkiator për lëvizjen e mjeteve – nevojitet për transportin e mjeteve të kërkuara, të cilët nuk mund të qarkullojnë në rrugë si: Eskavator me zinxhir gome, Makineri për shtrim dhe veshje kanali me beton etj.
- Çekic pneumatik - u referohet analizave në lidhje me gërmimet e dherave të trasesë së kanalit të cilat gjenden në tokë të fortë me shkëmbinj;
- Fadromë me goma - u referohet analizave në lidhje me mbushjet dhe ngjeshjen e dheut;
- Minieskavator- u referohet analizave kërkesa për minieskavatorin referohet arsyes për zonat dhe rrugicat e ngushta ku mund të haset vështirësi për eskavatorët e mëdha.
- Minifadrome me goma (mjet teknologjik me goma) - kërkesa për minifadromën referohet arsyes për zonat dhe rrugicat e ngushta ku mund të haset vështirësi për fadromat e mëdha.
- Greider dhe Damper (mjet teknologjik me goma) - ku për shkak të relievit dhe mungesës së infrastrukturës së mirfilltë rrugore ka vështirësi në lëvizjen e kamionave.
- Autobetoniere - u referohet analizave për ndërtimin e pusetave në lidhje me përzierjen e betonit. Kërkesa për numrin e autobetoniereve lidhet me faktin që punimet do kryhen në segmente të ndryshme dhe të garantohet efikasiteti për zbatimin e punimeve
- Autopompe betoni - u referohet analizave për ndërtimin e pusetave në lidhje me hedhjen e betonit.
- Autobot uji – referuar specifikimeve teknike, kërkohet për transportin e ujit për të kryer përzierjen e betonit dhe proceset e tjera të punës (larje etj.)
- Tokmak Elektrik për ngjeshje dheu - u referohet analizave për ngjeshjen e dheut.
- Vibrator Betoni - u referohet analizave në lidhje me vibrimin e betonit
- Armaturë Kallëperi betoni - u referohet analizave në lidhje me montimin e armaturave ku do të hidhet betoni.
- Matrapik - referuar specifikimeve teknike, kërkohet për thyerjen e gurëve/ shkëmbinjve të vegjël gjatë kanalit, ku nuk mund të kryhet gërmimi me mjet tjetër.
- Gjenerator - referuar specifikimeve teknike, kërkohet për sigurimin e furnizimit me energji elektrike të mjeteve/ pajisjeve gjatë kryerjes së punimeve.
- Saldatriçe - u referohet analizave kryerjen e saldimeve të tjera në lidhje me tubat dhe ndërtimin e portave.
- Aparat për kthim dhe prerje hekuri (Tranxhë hekuri) - referuar specifikimeve teknike, kërkohet për përpunimin dhe prerjen e hekurit që do të vendoset në vepër.
- Instrument për punime gjeodezike dhe Total Station - referuar natyrës së punimeve objekt kontrate, nevojiten për kryerjen e piketimeve dhe kontrollin e kuotave të punimeve gjatë zbatimit, me qëllim kryerjen e tyre sipas projektit.
- Motosharrë për prerje bimësie - referuar specifikimeve teknike, kërkohet për prerjen e bimësisë pyjore në rast pengese të kryerjes së punimeve të kanalit.

- Rrul vibrues dhe cilinder - u referohet analizave në lidhje me nivelimin dhe ngjeshjen e dheut;

ku sasia e tyre është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmasat e këtyre punimeve, ku një operator ekonomik pa këto mjete e pajisje nuk mund t'i realizojë këto punimeve. Gjithashtu në zbatim të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”, **njësia e prokurimit ka kërkuar që operatorët ekonomikë duhet të disponojnë dhe pajisjet mbrojtëse për punonjësit të cilët do të angazhohen për kryerjen e punimeve objekt kontrate.** Njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqesin operatorët ekonomik pjesëmarrës me qëllim vërtetimin e disponimit të tyre, dhe dokumentacionin tekniko-ligjor për automjetet të cilat duhet të regjistrohen në regjistrat publik për qarkullimin e tyre, kjo bazuar në dispozitat e neneve për regjistrimin (nenet 92–99) të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin përcaktohet se, *mjetet që qarkullojnë në rrugë duhet të jenë të regjistruara dhe të pajisura me targa.*

Ndërsa mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve dhe personelit janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) kantier për prodhimin e betonit në pronësi ose me qera ose me kontratë furnizimi (*Kontrata Noteriale e Qerasë/Furnizimit duhet të ketë kohëzgjatje për gjithë periudhën e realizimit të punimeve objekt kontrate*), ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë (*Çertifikatë, Plan-Vendosje & Kartelë e pasurisë*) dhe kontratën noteriale të qerasë/ furnizimit *në rast se kantieri është me qera ose kontratë furnizimi.*
- Leje Mjedisi nga QKL, sipas ligjit në fuqi.
- Dokumentacioni (*deklarata*) doganore dhe /ose fatura tatimore që vërteton pronësinë e linjës (*makineri/pajisje*) për prodhim betoni dhe inertesh.

Po ashtu, referuar punimeve objekt prokurimi, njësia e prokurimit vlerëson se, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë disponimin e 1 (një) kantier për prodhimin e betonit në pronësi, ose me qera ose me kontratë furnizimi, **pasi kjo i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët janë të aftë të sigurojnë sasinë e nevojshme të materialeve që do të përdoren në investim, si dhe sigurinë e cilësinë të mallrave/ produkteve,** duke qënë se kemi të bëjmë me produkt i cili duhet të prodhohet nga prodhues të licënsuar etj., kërkesë kjo në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi, ku në lidhje me përmbushjen e këtij kushti, njësia e prokurimit ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit ligjor në mbështetje të ligjit nr.10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (i ndryshuar), ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Dokumentacioni për përmbushjen e këtij kushti, kërkohej me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik pjesëmarrës disponon vetë (pronësi/ qera) kantierin, ose ka nënshkruar një kontratë furnizimi me një subjekt i cili disponon vërtet kantierin për prodhimin e betonit, pasi ky është dokumentacioni ligjor që vërteton ekzistencën e kantierit, në rast të kundërt nuk do vërtetohej dot nëse kontrata e furnizimit është lidhur me një subjekt i cili e disponon këtë kantier. Paraqitja e dokumentacionit përveç se nuk përbën kosto për operatorin ekonomik pjesëmarrës, por duhet të jetë pjesë dhe e kontratës që nënshkruhet, me qëllim vërtetimin se pala furnizuese është prodhuese e këtij malli.

2.3.6 Operatoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- Çertifikate ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Çertifikate ISO 14001-2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Çertifikate ISO 45001-2018 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurimit në Pune”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Çertifikate ISO 3834-2:2021, “Sistemi i Menaxhimit të cilësisë për proceset e saldimit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Nëse çertifikatat janë në gjuhe të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto çertifikata të jenë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast Bashkimi të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorezojë çertifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marre përsiper të realizojë, referuar kontrates së bashkepunimit të nënshkruar. Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH/EN/UNI mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të leshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.14 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,* si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të

saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001:2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Standardi ISO 3834-2:2021 përshkruan kërkesat e cilësisë për saldimit me shkrirje të materialeve metalike. Ai zbatohet si në punëtori ashtu edhe në vendet e instalimit në terren dhe është i dizajnuar për aplikime kritike ose me rrezik të lartë të saldimit. Standardi përfshin kërkesa të hollësishme për të siguruar besueshmërinë dhe sigurinë e produkteve të salduara në industri si ndërtimi dhe prodhimi. Për informacion më të detajuar, mund të referoheni dokumentacionit zyrtar të ISO-s këtu.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”. *Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, liçenca duhet të disponohet nga operatori ekonomik që do të marrë përsipër të realizojë grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar e bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: *“leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/B të këtij ligji”*. Në shtojcën I/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”. Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit Nr. 538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”*. Ndërkohë, sipas VKM Nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: *“Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”*.

2.3.8 Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- Tombino me tuba betoni Ø 600, Ø 800 (*Sipas specifikime teknike në projekt*)
- Gabion me rrjetë tel xingato (*Sipas specifikime teknike në projekt*)
- Saraçineske Ø 200 mm (*Sipas specifikime teknike në projekt*)
- Tub çeliku (*Sipas specifikime teknike në projekt*)

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.
- Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë çertifikatë nga Prodhuesi që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtoria.

Argumentimi: Paraqitja e ketyre dokumenteve është vlerësuar pasi në objekt kemi të bëjmë me materiale (artikuj) që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto artikuj të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: **Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogët ose pjesë të tyre**, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky objekt, një ndër elementet më të rëndësishëm të tij ka cilësinë e materialeve që do të vendosen në objekt, cilësinë e zbatimit të punimeve dhe atë të artikujve, në mënyrë që të arrijë qëllimet e tij afatgjata.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së artikujve të sipërcituar. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të Prodhuesit, Autoriteti ka mundësi të kontaktoje me Prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë. Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe

provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Vendosja e kriterit për **paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit** është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që Autoriteti të ketë një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave. Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike. Gjithashtu, bazuar në preventivin e punimeve, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ato duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t'i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, **me qëllim verifikimin/vlerësimin nga Autoriteti nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit**, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara.

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: **“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.**

2.3.9 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktor **një mostër për:**

- **Tuba çeliku** (Sipas specifikime teknike në projekt)

* *Mostrat e paraqitura duhet të jenë prerje ku të evidentohen të gjitha elementet, detajet sipas specifikimeve teknike. Mosdorëzimi i mostrës për secilën pajisje/material të kërkuar ditën e hapjes së*

ofertave dhe në rast se mostrat nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike e përcaktuara në DST, përbën kusht për s'kualifikim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.** 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 2 dhe 8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “2. **Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.**

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Në **nenin 40 pika 6** gërma “a” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose...”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, referuar materialeve/ pajisjeve që do të instalohen në investimin objekt prokurimi, të cilat duhet të jenë sipas standarteve dhe specifikimeve

teknike të kërkuara, për shkak të jetëgjatësisë që duhet të kenë si materiale, përtej periudhës së garancisë së punimeve të kërkuar, njësia e prokurimit e vlerëson të rëndësishëm kushtin e paraqitjes së mostrës për këto mallra/materiale ditën e hapjes së ofertave, **me qëllim që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të ketë mundësinë për të kontrolluar nëse këto materiale/ pajisje që do të përdoren në realizimin e punimeve objekt kontrate janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit.**

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 9 (nente) muaj kalendarike.

2.3.11 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratën **ku të shprehet se është dakort me menyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të perfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, (Në rast të shpalljes fitues).** Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Shtetit, e përcaktuar edhe tek Pika 2.10 e DST-së. Financimi është parashikuar në Buxhetin 2026-2028, afati i realizimit është 9 muaj.

Argumentimi: Në nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: **“a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”**

Njësia e prokurimit referuar të dhënave teknike të projektit, ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej 9 (nëntë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi, ku referuar vlerës dhe natyrës së punimeve që ka ky investim objekt prokurimi, **me qëllim vërtetimin se operatorët ekonomik ofertues kanë paraqitur një ofertë reale, të bazuar në një studim të hollësishëm të projekt - preventivit**, njësia e prokurimit vlerëson se ofertuesit duhet të paraqesin grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Në funksion të plotësimit të Shtojces Nr. 8 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit”, Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemer, Ates, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratores të shoqërise, Ortakun/Ortaket e shoqërise, përfaqësues të ndryshëm të posacem të shoqërise, drejtues të ndryshëm të shoqërise.

Bazuar në parashikimet e Rregullave të Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s'kualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në dokumentacionin e projektit objekt prokurimi, ku ndër të tjerash janë dërguar dhe Specifikimet Teknike për punimet që do të kryhen, të cilat janë hartuar nga një shoqëri e licensuar në projektim, duke qënë se këto specifikime teknike plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik”, dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për punimet objekt prokurimi.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT